



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.139

19 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.36, datë 15.10.2007

Me objekt: 1. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
2. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese..... 3807

Vendim i GJK
nr.37, datë 15.10.2007

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1107, datë 11.11.2005 të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe nr.1175, datë 13.10.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si të papajtueshme me Kushtetutën 3813

Vendim i GJK
nr.38, datë 15.10.2007

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.810, datë 16.11.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën 3816

Vendim i GJK
nr.39, datë 16.10.2007

Me objekt shpallja si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, të frazës “si dhe aktet e dhënies të kredive bankare” 3818

VENDIM
Nr.36, datë 15.10.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 2.5.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Dashmir Kore, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, me autorizim.
3. AKADEMIA E SHKENCAVE, përfaqësuar nga Luan Omari, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Kërkuesi, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nenet 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit të sipërcituar duke argumentuar në këto drejtime kryesore:

Së pari, neni 8 i ligjit bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Akademikëve mbi moshën 75 vjeç u mohohet e drejta e votës, që ka të bëjë me të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese të Akademisë së Shkencave. Akademikët vihen në pozita të pabarabarta, sepse anëtarët mbi 75 vjeç diskriminohen në raport me ata me moshë më të ulët. E drejta e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë është një e drejtë ligjore që buron nga pjesëmarrja në mbledhje dhe, për rrjedhojë, askush nuk mund të diskriminojë një person në ushtrimin e kësaj të drejte, nëpërmjet normës ligjore. Në mohimin e kësaj të drejte nuk jepen shkaqet që mund ta kenë detyruar ligjvënësin të përligj këtë diskriminim.

Së dyti, neni 7 i ligjit cenon një nga parimet e rëndësishme të ndërtimit dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, atë të *sigurisë juridike*. Sipas ligjit të mëparshëm akademikët mbanin për tërë jetën titullin “akademik”, si dhe përfitonin pagën për të gjithë kohën e anëtarësimit. Në ligjin aktual, dispozita e sipërcituar e ka përkeqësuar dukshëm statusin dhe pozitën e akademikëve. Kjo dispozitë ligjore nuk është rezultat i ekzistencës së një interesi publik apo i kërkesave të shtetit social. Përderisa pa asnjë shkak të përligjur është prekur parimi i sigurisë juridike, kjo dispozitë duhet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Së treti, mënyra e formulimit të neneve 5 dhe 6 të ligjit ka sjellë përjashtimin nga anëtarësia në Akademi e anëtarëve të jashtëm të saj, status që u njihet atyre në të gjithë praktikën botërore dhe parashikoheshin si të tillë në ligjin e mëparshëm. Aktualisht Akademia e Shkencave ka 5 anëtarë nderi, si dhe 21 anëtar të jashtëm të zgjedhur për kontribut shkencor të veçantë.

Së katërti, për shkak të heqjes së të drejtës së votës të një pjese të anëtarëve, neni 15 i

ligjit të atakuar është i pazbatueshëm, sepse ai ka parashikuar rregulla të riorganizimit të Akademisë së Shkencave për t'u zbatuar brenda 2 muajve dhe rregulla për zgjedhjen e organeve drejtuese për t'u zbatuar brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Për rrjedhojë, zgjedhja e organeve drejtuese, duke përjashtuar nga e drejta e votës akademikët mbi moshën 75 vjeç, nuk do të shprehte vullnetin e të gjithë anëtarëve të Akademisë.

Përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave, kërkuar rrëzimin kërkesës duke parashtruar pretendimet e tyre në këto drejtime kryesore:

- Shkaku i vetëm, i parashikuar në dispozitat konkrete, është social dhe lidhet me moshën, ndërkohë që vetë mosha nuk përbën shkak mosdiskriminimi sipas Kushtetutës. Neni 14 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk mund të merret për referim, sepse e drejta e votës së akademikëve nuk është e drejtë që mbrohet prej saj. Kuptimi i gjerë që mund t'i jepet për shkaqet e diskriminimit frazës “*dhe çdo rrethanë tjetër*”, të parashikuar në nenin 14, u referohet vetëm të drejtave të parashikuara në këtë Konventë;

- Nuk është prekur parimi i sigurisë juridike. Ndryshimi i të drejtës së fituar në formë dhe përmbajtje, qoftë edhe në kufizim të saj është gjithnjë i mundur kur bëhet fjalë për nevoja të arsyeshme për ndryshim dhe të diktura nga interesi publik dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit;

- Ligji nuk prek statusin juridik të akademikëve, megjithëse bën një rregullim të ri të Akademisë, i cili bazohet në një interes publik. Të drejtat e fituara të akademikëve janë ruajtur dhe nuk ka pasur asnjë përkeqësim të panevojshëm, arbitrar dhe të palogjikshëm. Dalja në pension në moshën 75 vjeç u garanton akademikëve vijueshmëri në ruajtjen e të drejtave të tyre. Të drejtat e tyre të fituara ata i ruajnë deri në daljen në pension. Besimi i tyre i ligjshëm tek shteti është ruajtur, dhe mbi këtë bazë, është respektuar parimi i proporcionalitetit. Gjithashtu, është rritur e drejta për shpërblim e tyre duke pasur parasysh një jetë akademike aktive;

- E drejta e votës ka ruajtur të njëjtën skemë si në ligjin e mëparshëm, sepse ka pasur edhe më parë anëtarë të jashtëm apo anëtarë nderi që nuk kishin të drejtë vote.

GJYKATA KUSHTETUESE,

dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushin, përfaqësuesin e kërkuar, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.9655, datë 11.12.2006, ka shfuqizuar ligjin nr.9182, datë 5.2.2004 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”. Në dallim nga ligji i mëparshëm, ligji i ri sjell ndryshime në përbërjen dhe strukturimin e anëtarësisë së Akademisë së Shkencave, në marrëdhëniet e punës, të pagës dhe të shpërblimit të anëtarëve të saj, si dhe në të drejtën e votës për anëtarët e Akademisë mbi moshën 75 vjeç.

Sipas ligjit të shfuqizuar, Akademia e Shkencave kishte, në përbërje të saj, anëtarë të Akademisë (*akademikë*), anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi, ndërsa sipas rregullimeve të bëra me ligjin në fuqi, përbërja e saj ndryshon me anëtarë të rregullt (*akademikë*), anëtarë të asociuar (*akademikë të asociuar*) dhe anëtarë nderi. Me ligjin nr.9182, datë 5.2.2004, anëtari i Akademisë mbante titullin “Akademik” për tërë jetën, si dhe përfitonte pagën për të gjithë kohën e anëtarësimit. Ligji aktual përcakton ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për akademikët mbi moshën 75 vjeç, duke zëvendësuar pagën për të gjithë kohën e anëtarësimit me pensionin dhe me shpërblimin për titullin “Akademik”. Sipas këtij ligji, me kalimin e kësaj moshe anëtari i Akademisë nuk mund të ushtrojë funksione drejtuese, por mund të marrë pjesë në mbledhje të Asamblesë së Akademisë pa të drejtë vote.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve, në cilësinë e kërkuar, kanë iniciuar një gjykim kushtetues, me anë të të cilit i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e neneve 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, si

dhe pezullimin e zbatimit të tij.

Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 11.4.2007, me qëllim të parandalimit të pasojave që mund t’u vijnë interesave shtetërore, në përgjithësi, dhe Akademisë së Shkencave në veçanti, nga zbatimi i menjëhershëm i dispozitave ligjore të kundërshtuara për antikushtetutshmëri, ka vendosur pezullimin e zbatimit të nenit 15 të ligjit të sipërcituar, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të saj.

Pretendimet e veta për papajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të këtyre dispozitave ligjore, kërkuesi ka synuar t’i mbështesë duke argumentuar cenimin e parimit të sigurisë juridike, mohimin e të drejtave të fituara në mënyrë të ligjshme, diskriminimin e akademikëve për shkak të moshës, si dhe pamundësinë e zbatimit të ligjit për konstituimin dhe mirëfunksionimin institucional të Akademisë së Shkencave, për shkak të paqartësisë dhe të pasaktësisë së përmbajtjes së dispozitave të kundërshtuara.

Përsa pretendohet nga kërkuesi për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese e gjen me vend t’i referohet jurisprudencës së vet, në të cilën ajo ka argumentuar se deri në çfarë mase siguria juridike, të drejtat e fituara, pritshmëria legjitime dhe besimi i qytetarëve tek shteti, që bazohen tek parimi i shtetit të së drejtës, do të përbëjnë mbështetje të fuqishme në funksion të ngritjes dhe të argumentimit të kërkesës për antikushtetutshmërinë e një norme ligjore.¹

Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi.

Pas analizës që Gjykata Kushtetuese u ka bërë, në kuptim të parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, pretendimeve të kërkuesit për cenimin e të drejtave të fituara, që kanë të bëjnë me përkeqësimin e situatës ekonomike të akademikëve pas ndryshimeve të ligjit, ajo çmon se nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Sipas nenit 2 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, Akademia është person juridik publik. Financimi i Akademisë së Shkencave nga shteti i jep këtij të drejtën të përcaktojë në mënyrë të pakushtëzuar raporte me akademinë për të rregulluar marrëdhëniet e punës, të pagave, të pensionit, të mbështetjes materiale, të statusit dhe të anëtarëve të saj. Ndryshimi në të ardhurat e akademikut që mbush moshën 75 vjeç nuk vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e prekjes së pagës që ai merr si anëtar i Akademisë, sepse ai përbën rrjedhojën e një ndryshimi veçanërisht specifik në marrëdhëniet e punës, që i detyrohet, në radhë të parë, daljes në pension të tij. Vendosja e kriterit të moshës në ushtrimin e funksioneve publike a shtetërore zbatohet për të gjithë personat juridikë publikë që funksionojnë me financime nga shteti. Një rregullim i këtij lloji parashikohet jo vetëm në ligj, por edhe në disa dispozita të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Pjesëmarrja me të gjitha angazhimet profesionale e shkencore, në kapacitet të plotë e të detyruar, deri në një moshë limit e nënkupton dhe e justifikon pagën për anëtarët e Akademisë së

¹ Vendimet nr.26, datë 2.11.2005; nr.34, datë 20.12.2005; nr.9, datë 26.2.2007 dhe nr.11, datë 4.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Shkencave. Nga ana tjetër, është e nevojshme të merret në konsideratë fakti se mbajtja pa limit moshe e statusit të akademikut, si dhe paga e dhënë për këtë titull, që parashikoheshin me ligjin e mëparshëm, tashmë të shfuqizuar, ushtrojnë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë si në sistemin e anëtarësimit në Asamblenë e Akademisë së Shkencave, ashtu edhe në vetë Buxhetin e Shtetit. Në këtë këndvështrim, caktimi i kufirit të moshës nga ligjvënësi, me qëllim ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe daljen në pension të akademikëve, nuk përbën përkeqësim në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes së tyre ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si argument për të shpallur se norma juridike që kundërshtohet është antikushtetuese.

Përsa i përket pretendimit për kufizim të statusit të akademikëve të futur me ligjin e ri, Gjykata Kushtetuese vlerëson se titulli “akademik” nuk u hiqet mbajtësve të tij, sepse sipas nenit 7 të këtij ligji, shpërblimin (dhe jo pagën) për këtë titull akademikët e rregullt e përfitojnë edhe pas moshës 75 vjeç. Sa i takon pretendimit të kërkuesit për përjashtim të anëtarëve të jashtëm nga statusi i akademikut, status që gëzohej prej tyre sipas ligjit të shfuqizuar, Gjykata Kushtetuese çmon se përfshirja ose jo e kësaj kategorie anëtarësh me karakter honorifik në strukturën e Akademisë nuk merr dimensionin e një të drejte të cenuar.

Në fushën e të drejtave që mbron parimi i të drejtave të fituara përfshihen kryesisht të drejtat themelore të individit, mbrojtja e të cilave shtrihet ndaj të gjitha fushave primare të marrëdhënieve ligjore civile. Ndryshimi i rregullimeve ligjore të një fushe të caktuar marrëdhëniesh, si atribut i pushtetit ligjvënës dhe si çështje që i takon gjykimit diskrecionar të këtij të fundit, duhet të mbajë parasysh respektimin e këtij parimi për ato të drejta mbi të cilat shtrihet dhe mbron ky parim. Mirëpo, të drejtat që kërkuesi i konsideron të cenuara nga ligji objekt shqyrtimi nuk përfshihen në të drejtat që mbron parimi i të drejtave të fituara, prandaj Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për antikushtetutshmërinë e nenit 8, ngre çështjen e diskriminimit për shkak të moshës që ligji i kundërshtuar u bën anëtarëve të Akademisë, duke iu mohuar atyre të drejtën e votës, gjë që shpie, sipas kërkuesit, në pamundësinë e zbatimit të ligjit për konstituimin dhe riorganizimin e Akademisë së Shkencave. Me arritjen e moshës 75 vjeç, anëtarëve të Akademisë u hiqet e drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese të saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, kërkuesi sjell si argument se ligji u njeh anëtarëve të Akademisë, nga njëra anë, të drejtën për të vazhduar, ashtu si edhe më parë, kryerjen e të njëjtave angazhime profesionale e shkencore, dhe nga ana tjetër, i vendos ata në pozita të pabarabarta me kolegët e tyre më të rinj.

Sikundër u pretendua nga kërkuesi në seancë gjyqësore, ligji, posaçërisht neni 8 i tij, ka krijuar një situatë faktike jonormale për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave, për arsye se zbatimi i tij e redukton ushtrimin e të drejtës së votës për të zgjedhur organet drejtuese vetëm në 11 akademikë nga 45 që është numri i përgjithshëm i anëtarëve të Asamblesë. Kjo situatë do të sjellë ilegjitimitet institucional, sepse i gjithë procesi i vendimmarrjes do të realizohej nëpërmjet votave të më pak se gjysmës së anëtarëve të Akademisë së Shkencave.

Me qëllim të realizimit të kontrollit të kushtetutshmërisë të dispozitës ligjore të kundërshtuar, Gjykata Kushtetuese vlerëson si të domosdoshme të sqarojë, pikësëpari, kuptimin e saktë dhe të qartë që i duhet dhënë asaj dispozite. Aspekt i rëndësishëm i respektimit të kushtetutshmërisë së normave juridike është qartësia, rrjedhshmëria, koherenca dhe mungesa e kontradiksionit logjik ndërmjet tyre. Ekzistenca e paqartësisë, e pasaktësisë, e kontradiksionit logjik ose e pazbatueshmërisë të normave ligjore, që mbartin drejtpërsëdrejti rrezikun e mosrespektimit të parimit të shtetit të së drejtës, shërben si argument i mjaftueshëm, në fushën e kontrollit kushtetues, për t’i konsideruar ato si të papajtueshme me Kushtetutën. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore që i lë shteg zbatuesit t’i jap asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vet norma.

Mbështetur në rezultatet e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese nxjerr përfundimin se neni 8 i ligjit të sipërcituar, për nga mënyra e rregullimit që ka synuar të arrijë nuk krijon garancitë dhe siguritë e mjaftueshme për ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni publik sipas standardeve

kushtetuese. Kjo dispozitë ligjore parashikon ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe daljen në pension të anëtarëve të Akademisë, duke vendosur si kufi maksimal moshën 75 vjeç. Fjalja e dytë e këtij neni parashikon pamundësinë e ushtrimit prej kësaj kategorie akademikësh të funksioneve drejtuese, si edhe pjesëmarrjen pa të drejtë vote të tyre në mbledhjet e Asamblesë së Akademisë. Pengesa për të ushtruar funksionet drejtuese dhe mospasja e të drejtës për të votuar në mbledhjet e Asamblesë së Akademisë janë justifikuar nga ligjvënësi me mbetjen e kësaj kategorie akademikësh, për shkak të daljes në pension, jashtë strukturave të institucionit. Megjithatë, ligji duke parashikuar si mundësi edhe shtyrjen e moshës së daljes në pension deri në 75 vjeç, ka lënë hapësirë për ushtrimin, si të funksioneve drejtuese, ashtu edhe të së drejtës së votës nga anëtarë të Akademisë, të cilët mund të përfitojnë, përpara kësaj moshe, daljen në pension për efekt të ligjit “Për sigurimet shoqërore”.

Një interpretim i tillë i dispozitës ligjore, që buron nga vetë formulimi i saj, krijon një situatë të paqartë, sepse pranon që edhe akademikët e dalë në pension të mund të zgjidhen në funksione drejtuese të Akademisë së Shkencave dhe të votojnë për organet e saj. Krahës kësaj, neni 8 parashikon se akademikët, të cilët tashmë i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Akademinë e Shkencave dhe kanë dalë në pension pas moshës 75 vjeç, mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë, por pa pasur të drejtë vote. Nga njëra anë, akademikëve nuk u lejohej të zgjidhen në funksione drejtuese dhe nuk u njihet e drejta për të votuar, nga ana tjetër parashikohet që ata të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë, duke u legjitimuar si anëtarë të rregullt të saj. Ligji nuk shprehet qartë për mbarimin e anëtarësisë, duke e nënkuptuar këtë si konsekuencë të heqjes të së drejtës së zgjedhjes për akademikët mbi moshën 75 vjeç. Mirëpo, një zgjidhje e tillë përbën një kufizim në të drejtat e anëtarësisë së akademikëve, kufizim që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi procesin e vendimmarrjes.

Neni 8, në formulimin e tij, përmban gjithashtu terma të pasaktësuar e të paqartë, të cilët mund të merren me kuptime të ndryshme duke krijuar terrenin për lindje keqkuptimesh e mosmarrëveshjes. Në këtë dispozitë përmendet nocioni “anëtarë të Akademisë”, duke mos specifikuar përfshirjen në këtë grupim vetëm të “anëtarëve të rregullt”, apo edhe të “anëtarëve të asociuar”. Kjo paqartësi e normës juridike nuk saktëson se për cilën kategori të anëtarëve të Akademisë vepron kufizimi i të drejtës së votës, si dhe ndalimi i ushtrimit të funksioneve drejtuese. Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese thekson se në standardet e interpretimit të ligjit, kuptimi i qartë dhe i saktë është ai që i jep ligjit pajtueshmërinë e tij me parimet dhe konceptet kushtetuese, në përgjithësi, dhe me respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, në veçanti.

Për Gjykatën Kushtetuese merr rëndësi të veçantë kryerja e analizës kushtetuese të nenit 8 të ligjit, për të nxjerrë përfundime lidhur me ndikimin që mund të ushtrojë kufizimi i të drejtës së votës së anëtarëve të Akademisë mbi moshën 75 vjeç në procesin e riorganizimit të Akademisë së Shkencave, të konstituimit të organeve drejtuese të saj, si dhe në zbatimin e parimeve kushtetuese të autonomisë institucionale dhe të lirisë akademike.

Liria akademike dhe autonomia institucionale janë parime të rëndësishme që kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 57 të saj parashikohet se “Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”. Zhvillimi i autonomisë akademike udhëhiqet nga ideja se shkencë mund të ekzistojë dhe të sjellë progres vetëm kur veprimtaria shkencore e akademike është e lirë dhe e pavarur. Mbi këtë bazë, parimi i lirisë akademike, që shpreh përpykjen për mbrojtjen nga ndikimet që mund t’i vijnë lirisë së mendimit shkencor nga individë ose pushtete jashtë sferës akademike, ka të bëjë me autonominë institucionale që përfshin kryerjen e një sërë veprimesh dhe ushtrimit e një sërë tagrash në pavarësi nga kontrolli i pushtetit shtetëror. Pikërisht, kjo vetëqeverisje akademike reflektohet në lirinë e kërkimit dhe të krijimtarisë shkencore, në hartimin e programeve të kërkimit shkencor, në zgjedhjen, në mënyrë të lirë dhe të pakomanduar nga të tjerë të organeve drejtuese, si dhe në përcaktimin në mënyrë të pavarur të rregullave për organizimin dhe funksionimin e vetë institucionit. Për respektimin e këtij standardi kushtetues, ligjvënësi detyrohet të marrë masa të përshtatshme për moskufizimin e mjeteve financiare e organizative, në mënyrë që liria akademike, kërkimi shkencor dhe përcjellja e rezultateve të tij tek publiku të mbeten të

paprekura.

Sanksionimi drejtpërdrejt në Kushtetutë i autonomisë së institucioneve arsimore e shkencore, si edhe i lirisë akademike përbën njëkohësisht një detyrim për ligjvënësin për të kufizuar pushtetet e tij mbi veprimtarinë e tyre në fushë të kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies. Nuk ka dyshim se është e drejtë e ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e përmbajtjes së lirisë akademike, në parashikimin e pavarësisë nga kontrolli shtetëror të aktiviteteve të institucioneve kërkimore shkencore dhe të arsimit të lartë, pa cenuar autonominë institucionale që garantohet me Kushtetutë. Ushtrimi i tagrës së vendimmarrjes përbën një shprehje të efektivitetit të autonomisë institucionale dhe ndërhyrja e shtetit, pikërisht në këtë aspekt thelbësor, do të sillte vështirësi në zbatimin e ligjit dhe do të cenonte standardet kushtetuese të kësaj autonomie, si edhe të lirisë akademike.

Në ligjin objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se nuk gjenden dispozita të plota që të rregullojnë tranzicionin për Akademinë e riorganizuar. Parashikimi me ligj i heqjes të së drejtës së votës për anëtarët e Akademisë mbi moshën 75 vjeç përbën mangësi thelbësore të ligjit, që sjell njëkohësisht edhe pamundësinë ligjore, në aspektin procedural, për të riorganizuar Akademinë e Shkencave.

Ligji nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 10 të tij, ka parashikuar Asamblenë si organin më të lartë drejtues të Akademisë, nga i cili do të zgjidhen të gjitha organet e tjera të saj, ndërkohë që akademikëve mbi moshën 75 vjeç u ka hequr të drejtën e votës. Ky parashikim ligjor sjell pamundësinë e mbledhjes dhe të konstituimit të këtij organi, për arsyen e thjeshtë se si anëtarë të rregullt të Akademisë mbeten të ushtrojnë të drejtën e votës vetëm 11 anëtarë, të cilët përbëjnë më pak se gjysmën e Asamblesë së Akademisë, Asamble që do të duhet të përbëhet nga 45 anëtarë.

Në këtë këndvështrim, ligji nuk ka parashikuar rregullime për mënyrën e vendimmarrjes, duke e bërë këtë në të njëjtën kohë edhe të pazbatueshëm. Referenca që vetë ligji ka bërë tek statuti për mënyrën e funksionimit të organeve drejtuese të Akademisë (neni 9/2) nuk sjell ndonjë zgjidhje, për arsye se statuti nuk ka autorizim ligjor të vendosë rregulla të ndryshme nga ato të ligjit dhe, njëherësh, as mund të bllokojë veprimin e ligjit, me anë të caktimit të rregullave që shmangin vullnetin e shumicës së anëtarësisë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se këto rregullime duheshin parashikuar drejtpërsëdrejti nga ligji dhe jo nga ndonjë akt i prejardhur nënligjor, siç është statuti.

Pikërisht, situata e re që krijohet me rregullimin ligjor të parashikuar në nenin 8, që u heq akademikëve mbi moshën 75 vjeç të drejtën e votës krijon një situatë të bllokimit institucional dhe me pasoja të padëshirueshme. Reduktimi i ndjeshëm i numrit të akademikëve, pengon jo vetëm arritjen e quorum-it të nevojshëm ligjor për vendimmarrje, gjë që sjell pamundësinë në zgjedhjen e organeve drejtuese, por krijon impakt frenues edhe ndaj lirisë akademike, në kuptimin që ajo vendoset nën presionin e kushteve të papërshtatshme për t’u ushtruar plotësisht.

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita ligjore e sipërcituar, në pjesën që mohon të drejtën e votës për akademikët mbi moshën 75 vjeç, me pasoje bllokimitin e procesit të vendimmarrjes institucionale dhe mosrespektimin e standardeve kushtetuese të lirisë akademike dhe të autonomisë institucionale, është e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të frazës

“pa të drejtë vote” në nenin 8 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;

2. Rrëzimin e kërkesës për nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

3. Heqjen e masës së pezullimit të zbatimit të nenit 15 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: F.Abdiu, K.Puto, S.Sadushi, S.Berberi, P.Plloçi.

Anëtarë kundër: Gj.Sauli, V.Kristo (Kryetar), Xh.Zaganjori, K.Peçi.

VENDIM

Nr.37, datë 15.10.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 7.5.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38 Akti, që i përket:

KËRKUES: ANA E JANI XHUMARI, përfaqësuar nga avokate Vitore Tusha, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHOQËRIA “ALB-TORONTO KONSTRUKSION” SHPK, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

2. ANA PAPA, JOLANDA JUBANI, përfaqësuar nga avokate Vitore Tusha, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.1107, datë 11.11.2005 të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe nr.1175, datë 13.10.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesit duke pretenduar se vendimet e mësipërme janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Gjykata e Apelit u ka hequr të drejtën e përfaqësimit në gjyq me avokat;

- Gjykata e Apelit ka cenuar parimin e gjykimit të paanshëm, sepse e ka gjykuar çështjen me gjyqtarë ushtarakë e jo civilë. Këtë parim e ka cenuar edhe se morën pjesë në trupin gjykues dy gjyqtarë që kishin marrë pjesë në një çështje me të njëjtët palë dhe me të njëjtat rrethana;

- Në vendimet e gjykatave nuk janë paraqitur argumente për mospranimin e pretendimeve të kërkuesve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesen e kërkuësve dhe të subjekteve të interesuara Ana Papa e Jolanda Jubani, që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar shoqërisë “Alb-Toronto Konstruktion” sh.p.k. që kërkoj rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr.623, datë 10.2.2005, ka vendosur rrëzimin e padisë së subjektit të interesuar, Shoqëria “Alb-Toronto Konstruktion” sh.p.k., ngritur kundër kërkuësve Jani e Ana Xhumari me objekt detyrimin për lirim truall për ndërtim. Njëkohësisht, ajo gjykatë, ka pranuar kundërpadinë e kërkuësve dhe të ndërhyrësve kryesorë Ana Papa, Jolanda Jubani e Margarita Xhumari, duke zgjidhur kontratën e sipërmarrjes të lidhur midis palëve për ndërtim mbi truallin pronë e kërkuësve, etj.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Shoqërisë “Alb-Toronto Konstruktion” sh.p.k., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1107, datë 11.11.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranimin e padisë së shoqërisë, duke detyruar kërkuësit për të liruar e dorëzuar truallin për ndërtim. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) me vendimin nr.1175, datë 13.10.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

Gjykimi në Gjykatën e Apelit është zhvilluar mbi bazën e ankimit të subjektit të interesuar, Shoqërisë “Alb – Toronto Konstruktion” sh.p.k. Ai ka filluar në datën 14.6.2005 dhe ka përfunduar në datën 4.11.2005, duke u shtyrë disa herë për mosformim të trupit gjykues, për shkak të dorëheqjes së gjyqtarëve dhe për shkak të gjendjes shëndetësore jo të mirë të avokatit të kërkuësit. Në seancën e fundit, më 4.11.2005, kërkuësit i paraqitën gjykatës një kërkesë për shtyrjen përsëri të gjykimit me pretendimin se avokati i tyre ka hequr dorë nga mbrojtja dhe kërkuan kohë për të gjetur një avokat tjetër.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se Gjykata e Apelit nuk i ka mohuar kërkuësve të drejtën për t’u përfaqësuar në gjyq me avokat e për të bërë mbrojtje të kualifikuar në këtë gjykim. Gjykimi i çështjes është shtyrë disa herë, përfshirë edhe rastin kur avokati i kërkuësve ishte i sëmurë. Kërkuësit pranojnë se, në seancën e fundit, avokati nuk u paraqit sepse një ditë më parë patën mosmarrëveshje për pagesën. Kështu, del se kërkuësi ka pasur kohën e nevojshme për të marrë të gjitha masat për të realizuar mbrojtjen e vet, por ai i ka lënë pa zgjidhur, deri ditën e fundit, mosmarrëveshjet me avokatin, i cili nga ana e tij ishte paraqitur në seancat e mëparshme për ta përfaqësuar. Në këtë mënyrë rezulton se kufizimi i parimit të mbrojtjes në gjyq dhe i parimit të barazisë së armëve kanë ardhur nga pakujdesia e vet kërkuësve.

Kërkuësit pretendojnë gjithashtu se Gjykata e Apelit ka cenuar parimin e paanësisë, sepse dy gjyqtarë të trupit gjykues kishin marrë pjesë e kishin shprehur mendimin e tyre për zgjidhjen e një çështje tjetër me të njëjtat palë e me të njëjtat rrethana dhe se çështja objekt shqyrtimi është gjykuar nga tre gjyqtarë ushtarakë.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se dy prej gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit kanë marrë pjesë në përbërje të trupit gjykues në shqyrtimin e çështjes me palë kërkuësit Jani e Ana Xhumari, subjektin e interesuar shoqërinë “Alb-Toronto Konstruktion” sh.p.k. e KRT të Bashkisë Tiranë, me objekt, anulimin e vendimit të KRT-së, Tiranë për dhënien e lejes së ndërtimit, zgjidhjen e kontratave të sipërmarrjes etj. Në vendimin e dhënë nga gjykata në atë rast, ashtu si edhe në çështjen objekt shqyrtimi, është pranuar se afati i parashikuar për nxjerrjen e lejes së ndërtimit nuk duhet të fillojë nga data kur firma e ndërtimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me kërkuësit, por nga data kur është nënshkruar kontrata e fundit me bashkëpronarët e tjerë. Fakti se në të dyja çështjet, interpretimi i ligjit nga gjyqtarët është i njëjtë, nuk do të thotë se është cenuar parimi i paanësisë në gjykim. Ky parim cenohet kur gjyqtarët mbajnë qëndrime duke u

pozicionuar në favor të njërës ose tjetrës palë, duke shfaqur mendim jashtë veprimtarisë procedurale të çështjes ose kur kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit etj., por jo në rastet kur gjyqtarët, duke zbatuar rregullat procedurale, bëjnë vlerësimin e interpretimin e problemeve juridike duke mbajtur qëndrime të arsyetuara për to, siç kanë vepruar në çështjen e lartpërmendur.

Parimi i paanësisë nuk është cenuar gjithashtu as nga pjesëmarrja e gjyqtarëve ushtarakë në gjykimin e kësaj çështje civile dhe as nga fakti që çështjen e gjykuan gjyqtarë ushtarakë, kur kishte gjyqtarë të tjerë civilë, të cilët nuk e kishin gjykuar atë më parë. Kjo pjesëmarrje është vendosur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Referimi tek vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut¹, nuk është i saktë. Ai vendim ka të bëjë me rastet që civilët e akuzuar për vepra penale, gjykohen nga gjyqtarët ushtarakë, kur duhet të gjykohen nga gjyqtarët civilë. Në çështjen në gjykim, gjyqtarët ushtarakë nuk janë ngarkuar të gjykojnë civilët për vepra penale, pra nuk realizojnë funksionin represiv të shtetit, por zgjidhin mosmarrëveshjet midis subjekteve fizikë e juridikë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: F.Abdiu, P.Plloçi, Gj.Sauli, K.Peçi, S.Sadushi

Anëtarë kundër: Kryetar V.Kristo, K.Puto, Xh.Zaganjori, S.Berberi

VENDIM

Nr.38, datë 15.10.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

¹ “Incal kundër Turqisë, RJD 1998 – IV, datë 9.6.1998.

me sekretare Brunilda Bara, në datë 13.7.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 Akti që i përket:

KËRKUES: EDMOND KAÇI, përfaqësuar nga avokat Maksim Haxhia, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.810, datë 16.11.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, pretendon se çështja penale në ngarkim të tij nuk është gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Pjesëmarrja në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë e të njëjtit gjyqtar që e ka gjykuar më parë këtë çështje në Gjykatën e Apelit, nuk garanton të drejtat e parashikuara në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sokol Sadushin, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan me vendimin nr.89, datë 14.4.2004 ka deklaruar të pafajshëm kërkuesin për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, parashikuar nga neni 114, shkronja “a”, pikat 1 e 4 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit, Durrës, me vendimin nr.333, datë 8.11.2004 ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor duke e deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese dhe e ka dënuar me 9 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, dhoma e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari kundër vendimit nr.333, datë 8.11.2004 të Gjykatës së Apelit, Durrës.

Pretendimi kryesor i kërkuesit lidhet me faktin se në gjykimin e kësaj çështje në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar, që e ka gjykuar këtë çështje në Gjykatën e Apelit, Durrës. Mbi këtë bazë, kërkuesi e ka ngritur shkeljen e pretenduar në nivelin kushtetues, duke iu referuar konceptit “*gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj*” në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese çmon se është e nevojshme të analizohet pretendimi i kërkuesit për cenim të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të kuptimit të termit “gjykatë e paanshme”.

Parimi i paanësisë që zbatohet për çdo çështje kërkon nga gjyqtarët që të mos kenë paragjykimë në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe të mosveprojnë në mënyrë të tillë që ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. “E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet”.¹

Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese ka theksuar në disa vendime të saj se “parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në

¹ Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.1.1970).

funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë”.¹

Paanshmëria është një parim kushtetues që duhet respektuar nga gjyqtari në çdo shkallë të procesit, detyrim nga i cili nuk përjashtohet as gjyqtari në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale: “Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit”. Pavarësisht nga natyra e veçantë që paraqet gjykimi në dhomën e këshillimit, vlerësimi nga pikëpamja ligjore i ekzistencës ose jo të shkaqeve të ngritura në rekurs nga një kolegji që në përbërje të tij ka gjyqtarin që e ka marrë këtë vendim në një tjetër shkallë gjykimi, është një moment i rëndësishëm që ndikon në rregullsinë e procesit gjyqësor.

Nga shqyrtimi i çështjes konkrete rezulton se Gjykata e Apelit e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, që ka shpallur kërkuesin të pafajshëm, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar me 9 vjet burgim. Rekursi ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka pasur në përbërje të tij gjyqtarin që e ka gjykuar këtë çështje në gjykimin në shkallë të dytë.

Gjykata Kushtetuese rithekson qëndrimin e mbajtur në raste të tjera të ngjashme “se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është pjesë e rëndësishme e procesit gjyqësor në tërësi dhe, në përputhje me natyrën e këtij shqyrtimi duhen respektuar parimet themelore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues”.

Mbi këtë analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se për shkak të cenimit të parimit të paanësisë, si element i të drejtës për proces të rregullt ligjor, kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.810, datë 16.11.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: V.Kristo (Kryetar), F.Abdiu, Gj.Sauli, Xh.Zaganjori, K.Puto, K. Peçi, S.Sadushi, S.Berberi, P.Ploçi.

VENDIM

Nr.39, datë 16.10.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

¹ Vendimi nr 12, datë 13.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 8.5.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEDEC

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, me autorizim.
3. BANKA E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Toni Gogu, me autorizim.
4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE, përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari, me prokurë.

OBJEKTI: Shpallja si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, të frazës “si dhe aktet e dhënies të kredive bankare”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pogradec, gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt “lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kontratën e huasë bankare”, ka pezulluar gjykimin dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, të frazës “si dhe aktet e dhënies të kredive bankare”, me argumentet e mëposhtme:

- Dispozita ligjore e sipërcituar, që u jep të drejtë subjekteve bankare të kërkojnë drejtpërsëdrejti në gjykatë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ndaj subjekteve private pa iu drejtuar më parë asaj me kërkesëpadi themeli, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Asnjë personi huamarrës nuk mund t’i ngarkohet një detyrim që rrjedh nga një kontratë e dyanshme pa u ezauruar më parë një gjykim publik, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

- Kjo dispozitë ligjore është diskriminuese për huamarrësin (qytetarë, persona fizikë e juridikë) për shkak se i vendos ata përpara faktit të kryer, duke i prezumuar debitorë për një përmbushje detyrimi. Diskriminimin pozitiv që dispozita konkrete u jep subjekteve bankare nuk e kanë qytetarët që në pozitën e huadhënësve lidhin kontratë huaje me subjekte të ndryshme;

- Mospjesëmarrja e personave huamarrës në procesin gjyqësor për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, u heq atyre mundësinë për t’u njohur me pretendimet dhe provat e palës kërkuuese, të bëjnë prapësimet e paraqesin prova, si dhe të debatojnë mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit në gjykim;

- Kjo dispozitë ligjore e vendos gjykatën në pozitë inferiore, pasi nuk mund të zhvillojë hetim gjyqësor të plotë që ka të bëjë me verifikimin e shumës dhe të kësteve mujore të papaguara, interesat mujore, si dhe penaltitetet, për arsye se procedura e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit është një procedurë vlerësimi të ligjshmërisë së titullit ekzekutiv dhe konstatimi të vlerës së detyrimit të përlogaritur nga ekspertë jashtëgjyqësorë.

Përfaqësuesit e të gjitha subjekteve të interesuara, kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar papajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dispozitës ligjore të sipërcituar në disa drejtime kryesore:

- Neni 510, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Civile është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve për barazi përpara ligjit, si dhe për një proces të rregullt ligjor;

- Procedura për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, sipas dispozitës konkrete të kontestuar nga kërkuesi, nuk është përfundimtare për të drejtat dhe detyrimet civile të palëve huamarrëse në një kontratë kredie bankare, për arsye se Kodi i Procedurës Civile parashikon dispozita të tjera, të

cilat garantojnë respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor;

- Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, i krijojnë mundësitë gjykatës që shqyrton kërkesën, të administrojë të gjitha provat gjyqësore dhe mbi bazën e tyre të krijojë bindjen për ekzistencën e detyrimit që buron nga kontrata e kredisë bankare, për shumën e saktë të tij, me qëllim parandalimin e çdo interpretimi të gabuar që subjekti bankar mund t'i bëjë përmbajtjes së titullit ekzekutiv;

- Lehtësitë procedurale që dispozita konkrete ligjore u njeh subjekteve bankare janë të përligjura për arsye të mbrojtjes së një interesi të rëndësishëm publik, që lidhet me stabilitetin e sistemit bankar dhe me mbledhjen e grumbullimin e mjeteve të lira financiare të publikut në formën e depozitave, me qëllim përdorimin e këtyre fondeve për kreditimin e qytetarëve dhe të ekonomisë;

- Kjo e drejtë ligjore nuk trajton në mënyrë të përqësuar, të pabarabartë dhe të padrejtë grupe sociale të caktuara, për shkaqet që parashikohen në nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

dëgjoj relatorin e çështjes Sokol Sadushin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Banka Kombëtare Tregtare, Pogradec me cilësinë e huadhënësit ka lidhur kontratë huaje me një shtetas për shumën e kredisë 50 000 USD me një afat 5-vjeçar. Meqenëse huamarrësi nuk ka shlyer pagesat e kësteve mujore, Banka Kombëtare Tregtare Pogradec, në bazë të nenit 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pogradec me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kontratën bankare.

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ka çmuar se në nenin 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, fraza “*si dhe aktet e dhënies të kredive bankare*” është me përmbajtje antikushtetuese. Në këto kushte, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi (Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pogradec), pasi ka konstatuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitës ligjore të kundërshtuar për antikushtetutshmëri dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, ka vendosur të pezullojë shqyrtimin e mëtejshëm dhe ta dërgojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, që ajo të shprehet për kushtetutshmërinë e saj.

Duke e konsideruar këtë dispozitë si antikushtetuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nxjerr përfundimet se janë antikushtetuese jo vetëm përfshirja nga ligjvënësi e “*akteve për dhënien e kredive bankare*” në kategorinë e titujve ekzekutivë, por edhe imponimi që i bëhet gjykatës për të zbatuar një proces të parregullt ligjor gjatë procedurës së lëshimit të urdhrit të ekzekutimit. Në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile janë listuar, krahas vendimeve gjyqësore, të gjithë titujt e tjerë ekzekutivë, mbi bazën e të cilëve bëhet ekzekutimi i detyrueshëm. Sipas kërkuetit, përfshirja në titujt ekzekutivë edhe të akteve për dhënien e kredive bankare e ka bërë më të lehtë për kreditorin sigurimin e titullit, duke e mënjanuar edhe kontrollin gjyqësor mbi akte të kësaj natyre. Sipas tij, një dispozitë e tillë ka cenuar barazinë ndërmjet kreditorit dhe debitorit dhe e ka diskriminuar huamarrësin, për arsye se e ka vendosur atë përpara faktit të kryer duke e prezumuar debitor.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të analizojë pretendimet e kërkuetit për të përcaktuar, nëse ligjvënësi gjatë hartimit të dispozitave procedurale përkatëse ka respektuar ose jo standardet kushtetuese, pretendime që ai synon t'i mbështesë me shmangien nga respektimi i parimeve të barazisë dhe të procesit të rregullt ligjor.

Çështjen e respektimit të standardeve kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese e vlerëson në këndvështrimin e kriterëve që justifikojnë kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga kjo pikëpamje ajo thekson se, në rastin në shqyrtim, kushtetutshmëria e normës ligjore nuk

duhet kontrolluar në drejtim të cenimit të parimit të barazisë para ligjit, parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Barazia në ligj dhe para ligjit kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk parakupton zgjidhje të njëjlojta për individë apo kategori subjektësh, të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme.

Sanksionimi me ligj si titull ekzekutiv i akteve për dhënien e kredive bankare krijon masa lehtësuese ligjore për rikuperimin sa më të shpejtë dhe efikas të kredive bankare, si dhe përbën një garanci për sistemin bankar që e vendos atë në një raport më të favorshëm kundrejt huadhënësve të tjerë. Në këtë rast, legjislatori e ka bërë evidente ekzistencën e një dallimi për subjektet bankare, duke e spostuar barrën e të provuarit nga huadhënësi tek huamarrësi, por një gjë e tillë nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pretendimin që ka parashtruar kërkuesi për diskriminimin pozitiv dhe për cenim të parimit të barazisë para ligjit.

Për Gjykatën Kushtetuese paraqet rëndësi të veçantë çështja, nëse dispozita ligjore, objekt kontrolli, mbështetet ose jo në kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për të justifikuar në pikëpamje të Kushtetutës, preken e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte, siç janë ato që kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore. Pra, kjo dispozitë kushtetuese kërkon vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes ligjore të shtetit, në varësi të natyrës së të drejtës, të karakterit të interesit publik që duhet të mbrohet, të rrethanave konkrete që e diktojnë një ndërhyrje në minimum dhe sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut.

Sistemi bankar zë vend të rëndësishëm në strukturat ekonomike të një vendi. Ai është një ndër aktorët kryesorë të ekonomisë së tregut, stabiliteti i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me stabilitetin makroekonomik të vendit. Në një sistem të tillë, bankat funksionojnë si ndërmjetës financiar duke mbledhur dhe grumbulluar mjetet e lira financiare të publikut, në formën e depozitave, për t'i përdorur këto fonde për të ushqyer sistemin e kreditimit. Dhënia e garancive ligjore për kthimin e sigurt të kredive bankare i shërben konsolidimit të sistemit bankar, si dhe ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e depozitave financiare të qytetarëve apo subjekteve të tjera. Nisur nga ky rol dhe nga atributet që i janë veshur këtij sistemi, parashikimi në ligj i lëshimit të urdhrit ekzekutiv, sipas kërkesës së subjektit bankar, me qëllim shlyerjen e shpejtë të kredisë pas skadimit të afateve kontraktore, ka pasur për qëllim të sigurojë ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik nga njëra anë, që synon qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe garantimin e kursimeve të depozituesve, si dhe respektimit të të drejtave të individit për një mbrojtje të plotë ligjore, nga ana tjetër.

Duke sanksionuar me ligj aktet e dhënies së kredisë bankare në cilësinë e titullit ekzekutiv, i kërkueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë nga huadhënësi, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ligjvënësi ka ndjekur një qëllim të përligjur dhe të justifikuar, në këndvështrimin e konceptit kushtetues “interes publik”.

Nga ana tjetër, mospjesëmarrja e personave huamarrës në procesin gjyqësor për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, pamundësia e tyre për t'u njohur me pretendimet dhe provat e palës kërkuese, të cilat ndikojnë në moszhvillimin e debatit në seancë mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit, përbëjnë elementë që, sipas kërkuesit, nuk gjenden të parashikuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata Kushtetuese çmon se elementë të tillë, që janë thelbësorë për zhvillimin e debatit kontradiktor në gjykim, nuk duhet t'i mungojnë një procesi ligjor, përveç rasteve të kufizimit të të drejtave, të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Për të nxjerrë përfundime për respektimin ose jo, në procedurat e përcaktimit dhe të ekzekutimit të detyrimeve që burojnë nga kontratat e kredisë, të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut) duhen analizuar hollësisht të gjitha tiparet që formojnë përmbajtjen e kësaj të drejte, pa u kufizuar vetëm tek dispozita e shkronjës “d” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.

Në këtë linjë arsyetimi, Gjykata Kushtetuese çmon se procedura për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas dispozitës së sipërcituar nuk është përfundimtare, por ajo përbën një fazë ndërmjetëse që përgatit palët në një marrëdhënie kredie bankare për fazën eventualisht pasardhëse të shqyrtimit të ekzistencës së detyrimit dhe të shumës së saktë të tij, ashtu siç parashikohet në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë procedurale i njeh të drejtën debitorit “të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas”. Meqenëse “akti për dhënien e kredisë bankare” nuk është “një vendim gjyqësor” ose “një vendim arbitrazhi”, nga një interpretim “a contrario” që i bëhet dispozitës, rezulton se debitori mund ta kundërshtojë ekzekutimin e titullit edhe për fakte të ndodhura përpara lëshimit të urdhrit të ekzekutimit. Pra, procedura gjyqësore për shqyrtimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, e parashikuar nga neni 609 i Kodit të Procedurës Civile, përbën fazën përfundimtare të zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes. Duke qenë e njëjtë me procedurën gjyqësore që ndiqet për shqyrtimin e çdo padie themeli, ajo i krijon të gjitha mundësitë që e drejta eventualisht e cenuar e kredimarrësit, të mund të rivendoset nëpërmjet garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Mbështetur në analizën e mësipërme, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në procedurën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, sipas nenit 510, shkronja “d” të Kodit të Procedurës Civile, gjenden të mishëruara të gjitha elementet kushtetuese të sipërcituara, mbi bazën e të cilave përligjet në mënyrë të arsyeshme kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pavarësisht se neni 510, shkronja “d” përbën një kufizim të lejueshëm dhe kushtetues të të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe në veçanti të elementit të kontadiktoritetit në gjykim, Gjykata Kushtetuese çmon se, në thelbin e vet, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk cenohet.

Për rrjedhojë, pretendimet e ngritura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pogradec për të shpallur dispozitën, objekt shqyrtimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nuk janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 134, pika 1, shkronja “d”; 145, pika 2 të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e shpalljes.

Anëtarë: V.Kristo (Kryetar), F.Abdiu, Gj.Sauli, Xh.Zaganjori, K.Puto, K.Peçi, S.Sadushi. S.Berberi, P.Plloçi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 18.10.2007
Doli nga shtypi më 19.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë